



EDUKIMI MJEDISOR



Mars 2025

Edukimi mjedisor i ndihmon nxënësit të njihen me çështje të rëndësishme dhe jetike si: ujin, ajrin, tokën, natyrën, biodiversitetin. Ai është veprimtaria akademike dhe praktike, që përfshinë studimin sistematik të mjedisit dhe gjithë marrëdhënieve që e shoqërojnë; përmes vëzhgimeve dhe eksperimenteve. Përgjatë tyre nxënësit përfshihen emocionalisht dhe fizikisht; ata mësojnë për zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave të ndotjes, mbetjeve, energjisë, ekonomisë qarkulluese. Nxënësit përfshihen në mbrojtjen e natyrës dhe njëkohësisht e duan edhe më shumë atë.

**“Shpresa kryesore e një kombi qëndron
në edukimin e drejtë të të rinjve të tij”
Erasmus Roterdami.**

Mentorët e tyre, të cilët janë specialistët e edukimit mjedisor në të 12 AdZM-të e vendit mbështesin, përfshijnë dhe ndërmarrin nisma të përbashkëta me nxënësit, për përmirësimin e mjediseve të ndryshme. Në sajë të këtyre veprimtarive ata zhvillojnë shprehje dhe dije mjedisore, që i bëjnë të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme e të mençur. Përmes edukimit mjedisor nxënësit e niveleve të ndryshme akademike përfitojnë:

vetëdije dhe ndërgjegjësim për mjedisin dhe sfidat mjedisore

kuptojnë dhe analizojnë probleme dhe çështje shqetësuese mjedisore

motivohen dhe përfshihen për përmirësimin e cilësisë së mjedisit në nivel lokal dhe kombëtar

ndërmarrin nisma dhe veprimtari që synojnë mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit



Përmes këtij manuali mujor Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura paraqet aktivitetet e zhvilluara nga 12 Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura, me nxënësit e shkollave të ndryshme në mbarë vendin dhe atyre që ndodhen pranë ZM-ve apo në zonat rurale, përgjatë muajit mars 2025. Aktivitetet janë zhvilluar në kuadër të ditëve mjedisore, promovimit të zonave të mbrojtura, lojërave të ndryshme edukative dhe argëtuese në mjediset e shkollave apo në natyrë, duke synuar gjithëpërfshirjen e nxënësve të të dy gjinive, niveleve të ndryshme ekonomike dhe vendndodhjen gjeografike.

Nxënës të
përfshirë **652**

Specialistë të
angazhuar **24**

Orë mjedisore
të realizuara **33**

33 Shkolla të
përfshira

33 Mësues të
përfshirë

“EDUKIMI MJEDISOR”, DURRËS



3 mars 2025, fauna e egër në PK “Qafështamë”

Në kuadër të Ditës Botërore të Jetës së Egër, specialistët e AdZM Durrës zhvilluan një aktivitet me nxënësit e klasës së dytë të shkollës 9-vjeçare “Zenel Tepshi”, Krujë.. Aktiviteti nisi me një sesion informues mbi rëndësinë ekologjike, ekonomike, shkencore dhe sociale të jetës së egër, si dhe ndikimin e veprimtarisë njerëzore në biodiversitet. Në vijim, nxënësit u njohën me faunën e Parkut Kombëtar “Qafështamë” nëpërmjet prezantimeve dhe aktiviteteve krijuese të organizuara nga specialistët. Aktiviteti u mbyll me ekspozimin e punimeve të tyre.

12 mars 2025, Dita Botërore “Mbill një lule”

Me rastin e Ditës “Mbill një Lule”, specialistët e AdZM Durrës zhvilluan një sesion informues me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Arbëria” Halil, ku u diskutua mbi rëndësinë e mbjelljes së luleve për natyrën dhe shëndetin tonë. Nxënësit u angazhuan në pyetje e përgjigje rreth ndikimit të luleve në ekosistem, ajër të pastër, mirëqenie emocionale, si dhe mënyrat për t'u kujdesur për to. Aktiviteti synoi të rrisë ndërgjegjësimin dhe dashurinë për natyrën që në moshë të hershme.

12 mars 2025, rëndësia e riciklimit

Në kuadër të Ditës Botërore të Riciklimit, specialistët e AdZM Durrës zhvilluan një aktivitet informues me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Jubë". Aktiviteti përfshiu një prezantim interaktiv mbi konceptin e riciklimit, llojet e materialeve të riciklueshme dhe përfitimet që ka riciklimi për mjedisin dhe ekonominë. Nxënësit morën pjesë në diskutime dhe pyetje-përgjigje për të kuptuar rëndësinë e riciklimit, hapat e tij dhe sfidat që has vendi ynë. Gjithashtu u trajtua ndikimi pozitiv i riciklimit në uljen e ndotjes së ujit dhe ajrit. Ky aktivitet synoi të rrisë ndërgjegjësimin e të rinjve për menaxhimin e përgjegjshëm të mbetjeve dhe ruajtjen e mjedisit.

21 mars 2025, Dita Botërore e Ujit

Specialistët e AdZM Durrës organizuan në shkollën 9-vjeçare "Jubë" një aktivitet me nxënësit për Ditën Botërore të Ujit. Gjatë orës mjedisore u diskutua rëndësia e ujit për jetën dhe ekosistemet, sfidat e ndotjes dhe ndryshimeve klimatike, si dhe mënyrat për ta kursyer dhe mbrojtur këtë burim të çmuar. Nxënësit morën pjesë në aktivitete krijuese duke ngjyrosur dhe plotësuar kuize mbi temën

“EDUKIMI MJEDISOR”, SHKODËR



3 mars 2025, Dita Botërore e Jetës së Egër

Në kuadër të Ditës Botërore të Jetës së Egër, specialistët e AdZM Shkodër, në bashkëpunim me Well Point, organizuan një orë mjedisore me pjesëmarrjen e nxënësve dhe mësuesve të shkollës 9-vjeçare “Salo Halili” si dhe grupin e Natyralistëve, në zonën e Shirokës, pjesë e RNM “Liçeni i Shkodrës”. Gjatë aktivitetit u prezantuan protokollet e monitorimit të faunës së egër dhe u diskutua mbi mënyrën e kundërimit dhe numërimit të shpendëve. Më pas, pjesëmarrësit, të ndarë në grupe, patën mundësinë të zhvillonin vetë kundërimin dhe censusin e shpendëve në terren, duke aplikuar njohuritë e fituara. Aktiviteti u pasurua edhe nga iniciativat krijuese të nxënësve, të cilët kishin përgatitur fole të improvizuara, të cilat u vendosën në pemë si simbol i kujdesit dhe përkushtimit ndaj mbrojtjes së jetës së egër. Ky aktivitet shërbeu si një përvojë edukuese dhe ndërgjegjësuuese për të rinjtë, duke forcuar lidhjen e tyre me natyrën dhe rëndësinë e ruajtjes së biodiversitetit në zonat e mbrojtura.

21 mars 2025, Dita Ndërkombëtare e Pyjeve

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Pyjeve, specialistët e AdZM Durrës, në bashkëpunim me nxënësit dhe mësuesit e shkollës 9-vjeçare “Nikë Luli”, organizuan një aktivitet sensibilizues me synim rritjen e ndërgjegjësimin për rolin e pyjeve në ruajtjen e biodiversitetit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së njeriut. Kjo ditë i kushtohet promovimit të ruajtjes, menaxhimit të qëndrueshëm dhe përmirësimit të shëndetit të pyjeve në mbarë botën. Gjatë aktivitetit, në oborrin e shkollës u mbollën fidanë të llojit lejland (Leyland cipres), si një mënyrë konkrete për të kontribuar në gjelbërimin e mjedisit. Mesazhi kryesor i përçarur tek nxënësit ishte: “Të pyllëzojmë mjediset tona”, duke i nxitur të jenë të ndërgjegjshëm dhe aktivë në mbrojtjen e natyrës.




flora dhe fauna

edukim mjedisor

pyllëzim

aktivitet krijues

“EDUKIMI MJEDISOR”, KUKËS



3 mars 2025, rëndësia e mbrojtjes së kafshëve të egra

Në Ditën Botërore të Jetës së Egër, specialistët e Administratës së Zonave të Mbrojtura (AdZM) Kukës organizuan një aktivitet sensibilizues në shkollën 9-vjeçare “Krumë”. Ky aktivitet pati si qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të nxënësve për rëndësinë e mbrojtjes së kafshëve të egra dhe ruajtjen e natyrës. Gjatë aktivitetit, specialistët zhvilluan një prezantim mbi biodiversitetin e Parkut Kombëtar “Alpet e Shqipërisë”, Parkut Natyror “Korab-Koritnik” dhe zonës së mbrojtur Munellë. Nxënësit u informuan mbi vendndodhjen, ushqimin dhe sjelljen e kafshëve të egra, si dhe rëndësinë e këtyre zonave për ekosistemet natyrore.

12 mars 2025, Kafshët e egra të PN Korab-Koritnik

Specialistët e AdZM Kukës zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Novosej”. Aktiviteti synonte të rrisë ndërgjegjësimin e fëmijëve për kafshët e egra të Parkut Natyror “Korab-Koritnik”. Gjatë orës mjedisore, nxënësit u informuan mbi mjediset ku jetojnë kafshët e egra, mënyrën e ushqyerjes dhe sjelljen e tyre, duke u përqëndruar në rëndësinë e ruajtjes së florës dhe faunës, si dhe të ekosistemit të këtij parku të mbrojtur.

27 mars 2025, orë mjedisore

Planeti Tokë është shtëpia jonë, dhe ruajtja e tij është një detyrë e përbashkët për të gjithë. Specialistët e AdZM Kukës zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare Shishtavec. Gjatë aktivitetit, u zhvillua një diskutim mbi idetë dhe nismat që mund të ndërmerren për mbrojtjen dhe ruajtjen e planetit Tokë. Nxënësit u njohën me rëndësinë e edukimit mjedisor dhe si mund të kontribuojnë ata në ruajtjen e burimeve natyrore dhe përmirësimin e kushteve të jetesës. Aktiviteti synonte rritjen e ndërgjegjësimit për nevojën e kujdesit ndaj mjedisit dhe veprimeve të vogla që mund të bëhen për të parandaluar dëmin e natyrës.

Alpet Shqiptare

ruajtja e biodiversitetit

PN Korab-Koritnik

ndërgjegjësim

“EDUKIMI MJEDISOR”, DIBËR



3 mars 2025, Dita Botërore e Jetës së Egër

Në Ditën Botërore të Jetës së Egër, AdZM Dibër organizoi një orë mjedisore me nxënësit e klasës së 4-të të shkollës “Myslim Shehu”. Gjatë aktivitetit, nxënësit dhe u njohën me disa nga llojet e faunës së egër që jetojnë në zonat e mbrojtura të Dibrës. Qëllimi i këtij takimi ishte rritja e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e natyrës dhe rëndësinë e ruajtjes së biodiversitetit. Nxënësit treguan interes dhe entuziazëm, duke fituar njohuri të reja mbi kafshët e egra dhe rolin e tyre në ekosistem.

12 mars 2025, “Mbill një lule”

Mbjellja e luleve është një mënyrë e bukur për të zbukuruar mjedisin dhe për të treguar dashuri ndaj natyrës. Për të nxitur këtë frymë tek fëmijët, në kuadër të ditës “Mbill një lule”, AdZM Dibër organizoi një orë mjedisore me nxënësit e klasës parashkollore të shkollës “Irfan Hajrullai”. Gjatë këtij aktiviteti, fëmijët krijuan disa nga llojet më të njohura të luleve, si dhe mësuën si të kujdesen për to, duke u njohur me nevojat e bimëve për ujë, dritë dhe dhe. Aktiviteti ishte edukues dhe zbavitës, duke nxitur tek fëmijët ndjenjën e përgjegjësisë dhe respektit për natyrën.



ditë botërore

edukim mjedisor

shërbimi pyjor

“EDUKIMI MJEDISOR”, LEZHË



3 mars 2025, Dita Botërore e Jetës së Egër

Specialistët e AdZM Lezhë, në kuadër të Ditës Botërore të Jetës së Egër, zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës së IV të shkollës "Fran Ivanaj". Gjatë këtij aktiviteti, fëmijët u njohën me kafshët e egra që jetojnë në Shqipëri, duke mësuar rreth vendndodhjes, ushqimit dhe sjelljes së tyre. Qëllimi ishte të ndërgjegjësohen për rëndësinë e ruajtjes së natyrës dhe të inkurajohen të jenë mbrojtës aktivë të saj. Në përfundim, nxënësit morën pjesë në një aktivitet krijues, ku shprehën në mënyrë artistike ato që kishin mësuar.

5 mars 2025, edukim mbi efikasitetin e energjisë

Dita e Efikasitetit të Energjisë është një moment i rëndësishëm për të ndërgjegjësuar brezat e rinj mbi rëndësinë e kursimit të energjisë dhe ruajtjes së mjedisit. Me këtë qëllim, specialistët e AdZM Lezhë zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës së V-të të shkollës "Ndoc Gjetja". Gjatë aktivitetit, nxënësit plotësuan një tabelë mbi konsumin e energjisë dhe menaxhimin e mbetjeve, duke reflektuar mbi zakonet e përditshme. Më pas u zhvillua një diskutim i hapur, ku fëmijët ndanë ide dhe mendime rreth sjelljeve pozitive dhe negative që ndikojnë në mjedis, si dhe sugjeruan mënyra konkrete për kursimin e energjisë dhe menaxhimin më të mirë të mbetjeve. Aktiviteti synoi të zhvillojë ndërgjegjësimin dhe përgjegjësinë mjedisore që në moshë të hershme.

12 mars 2025, Dita Botërore “Mbill një lule”

Kjo ditë mban këtë emër për të promovuar një gjest të thjeshtë, por me ndikim të madh – mbjelljen e një luleje – si shprehje e kujdesit ndaj natyrës dhe ndërgjegjësimi për rëndësinë e florës në jetën tonë të përditshme. Specialistët e AdZM Lezhë zhvilluan një aktivitet mjedisor me nxënësit e klasës së IV të shkollës 9-vjeçare "Besëlidhja". Ky aktivitet shërbeu si një mënyrë e bukur për të përcjellë mesazhe mbi rëndësinë e florës dhe kujdesin ndaj natyrës. Fëmijët treguan kreativitetin e tyre duke realizuar lule prej letre, duke reflektuar për rolin që lulet dhe bimësia kanë në jetën tonë.


ndërgjegjësim

zonat urbane

herbarium

bimësia e zonave të mbrojtura

“EDUKIMI MJEDISOR”, TIRANË



3 mars 2025, Dita Botërore të Jetës së Egër

Në aktivitetin për Ditën Botërore të Jetës së Egër, specialistët e AdZM Tiranë zhvilluan një orë edukative me nxënësit e klasave 2, 3 dhe 4. Ata u njohën me kafshët e egra të Parkut Kombëtar “Mali i Dajtit” dhe rëndësinë e tyre për ekosistemin. Përmes lojërave, ngjyrosjes dhe krijimit të zinxhirit ushqimor, nxënësit mësuam lidhjen mes kafshëve barëngrënëse dhe mishngrënëse, duke kuptuar më mirë nevojën për të mbrojtur natyrën dhe habitatet e saj.

7 mars 2025, krijimtari me nxënësit

Në shkollën 9-vjeçare “Hasan Tasin”, me nxënësit e klasës së gjashtë specialistët e AdZM Tiranë organizuan një aktivitet edukues dhe argëtues për festën e 7-8 marsit. Nxënësit, me shumë dashuri dhe emocion, krijuan kartolina ku përçuan urimet e tyre të përzemërta për nënën dhe mësuesen, duke përdorur ngjyra dhe lule natyrore. Ky aktivitet synoi të zhvillojë ndjenjat e vlerësimit dhe falënderimit në mënyrë kreative dhe të bukur.

Parku Kombëtar Dajt.

krijimtari

ditë botërore

“EDUKIMI MJEDISOR”, ELBASAN



3 mars 2025, fauna e egër

Specialistët e AdZM Elbasan zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Isuf Gjura" në Kuturman, në kuadër të Ditës Botërore të Jetës së Egër. Gjatë aktivitetit u informuan dhe u ndërgjegjësuam për rëndësinë e mbrojtjes së kafshëve të egra të Shqipërisë, duke u fokusuar veçanërisht te banorët e Parkut Kombëtar "Shebenik" dhe Peizazhit të Mbrojtur "Kuturman – Qafë Bush". Ky aktivitet synoi rritjen e njohurive dhe respektit ndaj natyrës dhe biodiversitetit lokal.

5 mars 2025, eficienta energjetike

Dita Botërore e Eficencës Energjetike u krijua më 5 mars 1998, për të rritur ndërgjegjësimin mbi përdorimin e qëndrueshëm të energjisë. Me këtë rast, në shkollën "Rahman Çota" Hotolisht u zhvillua një orë mjedisore me pjesëmarrjen e 22 nxënësve dhe 2 mësuesve. Specialistët e AdZM Elbasan prezantuan materiale edukative mbi rëndësinë e eficientës energjetike dhe energjinë e rinovueshme. Aktiviteti u zhvillua në formë bashkëbisedimi, ku nxënësit nëpërmjet pyetjeve dhe diskutimeve zgjeruan njohuritë e tyre.

12 mars 2025, Dita Botërore "Mbill një lule"

Me rastin e Ditës "Mbill një Lule", në shkollën 9-vjeçare Librazhd-Katund u zhvillua një aktivitet nga specialistët e AdZM Elbasan, me qëllim të rritjes së ndjeshmërisë ndaj mjedisit. Nxënësit mbollën lule në ambientet e shkollës, duke mësuar rëndësinë e kujdesit për natyrën dhe kontributin e tyre për një mjedis më të bukur dhe të shëndetshëm.

Parku Kombëtar Shebenik

mbjellje fidanësh

ditë botërore

bashkëbisedim

zona të mbrojtura

13 mars 2025, Dita Botërore e Veprimit për Lumenjtë

Në kuadër të kësaj dite, specialistët e AdZM Elbasan zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës "Ramazan Bala", pjesë e Parkut të Mbrojtur "Kuturman – Qafë-Bush".

Qëllimi ishte rritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë e lumenjve dhe nevoja për mbrojtjen e tyre nga ndotja. Aktiviteti synoi të nxisë dashurinë për natyrën dhe të promovojë vlerat e pasurive ujore te brezi i ri.

25 mars 2025, zonat e mbrojtura të bashkisë Gramsh

Me qëllim njohjen dhe promovimin e zonave të mbrojtura në territorin e Bashkisë Gramsh, specialistët e AdZM Elbasan zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës "Asllan Shahini".

Gjatë aktivitetit, nxënësit u njohën me Parkun Kombëtar Mali i Tomorrit, monumentet e natyrës, si dhe florën e faunën e pasur të zonës — vlera të cilat po tërheqin gjithnjë e më shumë vizitorë vendas dhe të huaj.

“EDUKIMI MJEDISOR”, FIER



3 mars 2025, Dita Botërore e Jetës së Egër

Në kuadër të Ditës Botërore të Jetës së Egër, AdZM Fier organizoi një orë mjedisore ndërgjegjësuere me nxënësit e shkollës 9-vjeçare Mizë, në Bashkinë Divjakë. Qëllimi i aktivitetit ishte njohja e të rinjve me pasuritë natyrore të zonës dhe rëndësinë e mbrojtjes së faunës së egër. Nxënësit u prezantuan me disa nga llojet më karakteristike të faunës së Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta, si pelikani kaçurrel, çafka, dallëndyshja detare dhe shumë shpendë të tjerë të mbrojtur. Ora u zhvillua në formë bashkëbisedimi, duke inkurajuar nxënësit të shprehnin mendimet e tyre dhe të kuptonin rolin që kanë në mbrojtjen e natyrës. Aktiviteti shërbeu si një hap i rëndësishëm në ndërtimin e ndjenjës së përgjegjësisë mjedisore tek brezi i ri.

11 mars 2025, vizitë në qendrën e vizitorëve

Nxënësit e Albanian College Tirana zhvilluan një vizitë mësimore në Qendrën e Vizitorëve të Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta, duke e shndërruar atë në një hapësirë edukimi dhe eksplorimi natyror. Gjatë vizitës, nxënësit patën mundësinë të njihen nga afër me rolin e ligatinave dhe rëndësinë e tyre në ruajtjen e ekosistemeve përreth. Ata mësuuan si këto habitate kontribuojnë në biodiversitet, filtrimin natyror të ujit, dhe si shërbejnë si strehë për shumë llojshmëri shpendësh dhe speciejsh të mbrojtura. Kjo përvojë praktike forcoi lidhjen e tyre me natyrën dhe theksoi rëndësinë e arsimit mjedisor në terren, si një mënyrë efektive për të rritur ndërgjegjësimin dhe përgjegjësinë ndaj mjedisit.

27 mars 2025, vëzhgimi i shpendëve

Specialistët e AdZM Fier mirëpritën nxënësit e shkollës Kings Tirana për të realizuar një aktivitet Birdwatching. Fillimisht, nxënësit u njohën me informacionin në Qendrën e Vizitorëve, ndërsa më pas, duke ndjekur shtegun Godulla, patën mundësinë të vëzhgonin disa lloje shpendësh në habitatin e tyre natyror.

12 mars 2025, Dita Botërore “Mbill një lule”

Nxënësit e Albanian College Tirana, pas praktikës mësimore në Qendrën e Vizitorëve të Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta mbi rëndësinë e ligatinave, u angazhuan në një aktivitet tjetër me stafin e AdZM Fier. Në kuadër të Ditës “Mbill një lule”, ata mbollën disa lule, duke kontribuar në përmirësimin e ambientit dhe duke mësuar vlerën e ruajtjes së natyrës dhe biodiversitetit përmes veprimeve praktike.

13 mars 2025, Parku Kombëtar “Lumi Vjosa”

Në kuadër të shpalljes së Parkut Kombëtar “Lumi Vjosa”, stafi i AdZM Fier zhvilloi një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Xhevit Fetahu”, në Bishan, Fier. Gjatë orës, nxënësit u njohën me vlerat natyrore dhe rëndësinë e mbrojtjes së Parkut Kombëtar “Lumi Vjosa”, duke theksuar rolin e tij në ruajtjen e biodiversitetit dhe ekosistemeve të pasura të zonës.

15 mars 2025, orë mjedisore

Me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Ramiz Ceka” u zhvillua një orë mjedisore gjatë së cilës ata u njohën me vlerat e Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta. Këto orë kanë një rëndësi të veçantë, pasi i lejojnë nxënësit të lidhen direkt me natyrën, të prekin dhe përjetojnë nga afër mjedisin që studiojnë. Ndërgjegjësimi i brezit të ri për rëndësinë e mbrojtjes së ekosistemeve natyrore bëhet shumë më efektiv kur fëmijët kanë mundësinë të shohin dhe të kuptojnë drejtpërdrejt pasuritë natyrore që i rrethojnë.

18 mars 2025, unazimi shpendëve

Në bashkëpunim me Shoqatën Ornitologjike të Shqipërisë (AOS) dhe AdZM Fier, me nxënësit e shkollës “Mihal Nako” në Fier-Seman u organizua aktiviteti “Ora e Hapur në Natyrë” në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta. Nxënësit morën pjesë në një kamp unazimi shpendësh, ku u njohën me teknikën dhe rëndësinë e këtij procesi për monitorimin dhe ruajtjen e shpendëve. Aktiviteti synoi të rrisë ndërgjegjësimin për biodiversitetin dhe mbrojtjen e natyrës, duke nxitur përgjegjësinë e brezit të ri ndaj mjedisit.

19 mars 2025, unazimi shpendëve

Në ditën e dytë të Kampit të unazimit të shpendëve në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta, nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar Çermë - Sektor, Divjakë, morën pjesë aktivisht në procesin e unazimit. Pas kapjes së shpendëve në rrjetat e vendosura, ata regjistruan me kujdes orën, datën dhe karakteristikat e çdo shpendi. Më pas, secilit shpend i vendosën një unazë të vogël identifikuese, që ndihmon në studimin e lëvizjeve dhe sjelljeve të tyre në rast se kapen sërish në të ardhmen.

20 mars 2025, unazimi shpendëve

Në ditën e tretë të kampit, nxënësit e Shkollës së Mizës, Divjakë, vazhduan të angazhohen në këtë aktivitet edukativ. Kampi, i organizuar nga Shoqata Ornitologjike e Shqipërisë (AOS) në bashkëpunim me AdZM Fier, fokusohet në njohjen dhe mbrojtjen e shpendëve të egër përmes teknikave të unazimit dhe monitorimit. Pjesëmarrja në këtë kamp u mundëson nxënësve të fitojnë njohuri të thelluara mbi rëndësinë e ruajtjes së biodiversitetit dhe të marrin përvojë praktike në mbrojtjen e mjedisit natyror.

21 mars 2025, Dita Ndërkombëtare e Pyjeve

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Pyjeve, së bashku me nxënësit e shkollës së Mesme të Bashkuar Çermë - Sektor, Divjakë, AdZM Fier organizoi një aktivitet pastrimi në zonat përreth shkollës dhe pyjeve pranë. Ky aktivitet kishte për qëllim ndërgjegjësimin e të rinjve për rëndësinë e ruajtjes së pyjeve dhe mbrojtjen e mjedisit natyror. Gjatë aktivitetit, nxënësit u angazhuan në pastrimin e mbetjeve dhe mësuan për ndikimin negativ të ndotjes në ekosistemet pyjore. Përmes këtij veprimi, u nxit edhe ndjenja e përgjegjësisë dhe kujdesit ndaj natyrës, duke promovuar një mjedis më të pastër dhe të shëndetshëm për komunitetin.

“EDUKIMI MJEDISOR”, KORÇË



edukim mjedisor
gështenjë e egër

mbjellje fidanësh
shtigje



11 mars 2025, mbjellje fidanësh

Specialistët e AdZM Korçë organizuan një aksion mbjelljeje me nxënësit e klasës së 10-të të shkollës “Raqi Qirinxhi” në Korçë. Së bashku me ta, u mbollën fidanë të llojeve të ndryshme, si gështenjë e egër, kumbull e egër dhe plep, në oborrin e shkollës. Pas përfundimit të mbjelljeve, specialistët dhanë mesazhe për rëndësinë e mbjelljes së pemëve dhe mbrojtjes së mjedisit, duke nxitur ndërgjegjësimin dhe përgjegjësinë mjedisore tek nxënësit.

12 mars 2025, “Mbill një Lule”

Në kuadër të Ditës “Mbill një Lule”, në shkollën e Mesme “Raqi Qirinxhi” u zhvillua një aktivitet mjedisor me nxënësit e klasës së 12-të. Gjatë këtij aktiviteti, nxënësit u njohën me rëndësinë e mbjelljes së luleve dhe rolin e tyre në pasurimin e biodiversitetit dhe përmirësimin e mjedisit. Ata mësuuan procesin e mbjelljes së farave dhe u angazhuan në përkujdesjen e tyre për t'u siguruar që farat të mbijnë dhe lulëzojnë.

12 mars 2025, orë mjedisore

Në kuadër të aktiviteteve të Ditës Botërore “Mbill një Lule” specialistët e AdZM Korçë organizuan një veprimtari mjedisore me nxënësit e klasës së 6-të të shkollës “Kozma Gjokë Basho” në Pogradec. Aktiviteti përfshiu pastrimin e shtegut drejt kalasë dhe mbjelljen e rreth 40 fidanëve, ndër të cilët gështenjë e egër, qershi e egër dhe akacie.

17 mars 2025, ndërgjegjësimi për ndotjen

Specialistët e AdZM Korçë zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës së 10-të, ku në fokus ishte ndotja e mjedisit dhe ndikimet e saj. Gjatë orës, u diskutuan format kryesore të ndotjes, pasojat në shëndetin publik dhe në ekosisteme, si dhe mënyrat konkrete për parandalimin e saj. Përmes bashkëbisedimit aktiv, nxënësit dhanë mendimet e tyre dhe morën këshilla praktike për ruajtjen e mjedisit. Aktiviteti shërbeu për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të nxitur përfshirjen individuale në mbrojtjen e natyrës.

21 mars 2025, Dita Ndërkombëtare e Pyjeve

Në kuadër të kësaj dite, specialistët e AdZM Korçë zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës së 11-të të shkollës “Gjergj Pekmezi”. Gjatë orës, përmes një prezantimi me PowerPoint, u shpjegua rëndësia e kësaj dite si dhe roli që pyjet luajnë në ruajtjen e klimës, biodiversitetit dhe jetës së qëndrueshme. U trajtuan gjithashtu temat që lidhen me zonat e mbrojtura dhe pyjet e rajonit të Pogradecit, duke nxitur ndërgjegjësimin e të rinjve për mbrojtjen e pasurive natyrore dhe ruajtjen e ekosistemeve pyjore.

22 mars 2025, Dita Botërore e Ujit

Është thelbësore që nxënësit të njihen me Ditën Botërore të Ujit, pasi kjo u ofron atyre një kuptim më të thellë mbi rëndësinë e ujit si burim jetik për të gjitha gjallesat. Në këtë kuadër, më 22 Mars, në shkollën e mesme “Gjergj Pekmezi” në Pogradec u zhvillua një orë mjedisore me nxënësit e klasës së 11-të, organizuar nga specialistët e AdZM Korçë. Gjatë këtij aktiviteti u trajtuan tema të rëndësishme si uji i pijshëm, burimet natyrore ujore dhe biodiversiteti që mbështetet prej tyre. Nxënësit u inkurajuan të reflektojnë mbi mënyrat se si mund të kontribuojnë në mbrojtjen e këtij burimi të pazëvendësueshëm, duke kuptuar se menaxhimi i qëndrueshëm i ujit është përgjegjësi e përbashkët.

27 mars 2025, Rrëqebulli i Ballkanit

Në një aktivitet edukues me nxënësit e klasës së 12-të në shkollën “Raqi Qirinxhi”, u trajtua tema e Rrëqebullit të Ballkanit, një specie e veçantë që gjendet në Parkun Kombëtar të Prespës. Gjatë orës u ndanë informacione të përgjithshme mbi këtë gjitar dhe u theksua se ai është një specie në rrezik. Mesazhi kryesor për nxënësit ishte njohja dhe vlerësimi i gjitarëve që jetojnë në këtë zonë të mbrojtur, për të rritur ndërgjegjësimin mbi ruajtjen e tyre.

“EDUKIMI MJEDISOR”, GJIROKASTËR



19 mars 2025, orë mjedisore

Specialistët e AdZM Gjirokastrë zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës së pestë në shkollën 9-vjeçare "Kamber Bënja" në Këlcyrë. Tema e orës ishte Parku Kombëtar "Lumi Vjosa", ku nxënësit u njohën me rëndësinë e këtij parku natyror, biodiversitetin dhe vlerat e tij ekologjike. Aktiviteti synoi të risë ndërgjegjësimin për ruajtjen e ambientit dhe të motivojë brezin e ri për të mbrojtur këtë pasuri të rrallë natyrore.

21 mars 2025, Dita Ndërkombëtare e Pyjeve

Nxënës të shkollës së mesme "Abaz Shehu" të Tepelenës morën pjesë aktivisht në aksionin e mbjelljes së bimëve autoktone në zonën e Shelgut, Tepelenë. Në Ditën Ndërkombëtare të Pyjeve, AdZM Gjirokastrë në bashkëpunim me Eco Albania organizoi këtë iniciativë ku u mbollën plepi, rapi dhe sheldu, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm për rikthimin e pyjeve breglumore dhe mbrojtjen e biodiversitetit në rajon. Ky aktivitet forcoi ndërgjegjësimin dhe përfshirjen e komunitetit lokal në ruajtjen e natyrës.

27 mars 2025, Vlerat e Parkut Kombëtar "Lumi Vjosa"

Specialistët e AdZM Gjirokastrë zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës "Kamber Bënja", ku u trajtua tema "Vlerat e Parkut Kombëtar Lumi Vjosa". Nxënësit u njohën me rëndësinë ekologjike të këtij parku, biodiversitetin e pasur, si dhe rolin e tij në ruajtjen e ekosistemeve dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore. Ky aktivitet synoi të risë ndërgjegjësimin e brezave të rinj për mbrojtjen e natyrës dhe për rolin jetik që kanë zonat e mbrojtura në ekuilibrin e mjedisit.

“EDUKIMI MJEDISOR”, VLORË

03 20



3 mars 2025, fauna e egër në zonat e mbrojtura

Në kuadër të Ditës Botërore të Jetës së Egër, specialistët e ADZM Vlorë zhvilluan një orë mjedisore, ku morën pjesë studentë të Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Gjatë aktivitetit, u njohën me lagunat në Shqipëri dhe rëndësinë e tyre për mjedisin dhe gjallesat që jetojnë aty. U prezantuan praktikat e monitorimit që realizohen për mbrojtjen dhe ruajtjen e këtyre ekosistemeve të veçanta. Studentët u njohën gjithashtu me strukturën biofizike të ligatinave, proceset ekologjike që i karakterizojnë dhe faktorët mjedisorë që ndikojnë në funksionimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

20 mars 2025, njohja me Breshkat Detare

Në Qendrën e Breshkave Detare në Vlorë u zhvillua një orë mjedisore me studentë të Departamentit të Kimisë nga Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë. Gjatë aktivitetit u prezantuan metodat smart të monitorimit të breshkave detare dhe u njohën me biologjinë dhe sjelljet e këtyre kafshëve. Përveç kësaj, studentët aplikuan praktika në terren duke përdorur kite monitorimi për mbledhjen e të dhënave. Qëllimi kryesor ishte të kuptohej metoda smart e monitorimit dhe të mësohej si të veprohet në rast se gjendet një breshkë detare në breg të detit, duke theksuar rëndësinë e mbrojtjes së kësaj specie të veçantë.